



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**BM Group**”sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “**Mirëmbajtja e linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës- Kontratë dy vjeçare** “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7827-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-064-211, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**BM Group**”sh.p.k, e dt.24.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja e linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës- Kontratë dy vjeçare** “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7827-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-064-211, kundër **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** te AK –së, të datës 18.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 18.10.2022, në platformën elektronike të KRPP-së;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.24.10.2022, Operatori Ekonomik “**BM Group**”sh.p.k.,ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “**Mirëmbajtja e linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës- Kontratë dy vjeçare** “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7827-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-064-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron sepse Autoriteti kontraktues, me dt.29.09.2022, përmes formularit standard për tenderët jo-normalisht të ulët ka kërkuar nga Operatori ekonomik i propozuar për kontratë që të jap shpjegim detal se ku është bazuar në çmimet e ofruara për pozicionet që kanë çmim jo-normalisht të ulët si dhe të dorëzoj me shkrim një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur duke zbërthyer në mënyrë të detajuar kalkulimin e çmimit të paraqitur për secilin pozicion.

Me dt.03.10.2022, Operatori ekonomik i propozuar për kontratë Labinot M.Krasniqi B.I., ka ofruar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, ku pas analizimit dhe krahasimit të dokumenteve të dorëzuara, Autoriteti Kontraktues ka vendosur që të njëjtin ta propozoj për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës